

Me shtypjen/ klikimin e butonit “Pëlqim”, jap pëlqimin tim të shprehur që NLB Banka (në vijim: Banka) të mbledhë, përpunojë, ruajë, të dhënat e mia personale të lartcekura, si dhe të dhënat që mund të bëhen të njohura më vonë dhe nëse është e nevojshme, të ndajë ato me anëtarët e NLB Group dhe kompanitë e kontraktuara nga NLB Banka, për qëllimet e shqyrtimit, vlerësimit dhe përpunimit të këtij aplikimi, për lidhjen, administrimin dhe ekzekutimin e marrëdhënies kontraktuale me Bankën.

Përpunimi dhe transferimi i të dhënave të mia do të kryhet në përputhje me Ligjin në fuqi për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, aktet nënligjore përkatëse, si dhe në përputhje me politikat e brendshme të NLB Banka.

Jam i/e informuar se të dhënat e mia do të trajtohen me kujdes dhe do të ruhen për aq kohë sa është e nevojshme për realizimin e qëllimeve të mësipërme, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore për ruajtjen e tyre.

Gjithashtu, jam i/e informuar se kam të drejtë të tërheq pëlqimin në çdo kohë, pa ndikuar në ligjshmërinë e përpunimit të kryer para tërheqjes së pëlqimit, si dhe të ushtroj të drejtat e mia për qasje, korrigjim, kufizim, kundërshtim dhe fshirje të të dhënave personale, duke kontaktuar Bankën përmes:

Email: dpoprishtina@nlb-kos.com

Numër kontaktues: 038 240 230 100

Postë: NLB Banka SH.A, rruga Ukshin Hoti, numër 124, 10000, Prishtinë.

Për më shumë informacion mbi mënyrën se si Banka përpunon të dhënat e juaja personale, ju mund të referoheni në linkun [Informacion i Përgjithshëm për Mbrojtjen e të Dhënave Personale Final 28.04.2025 ALB.pdf](#).

Deklaroj dhe konfirmoj saktësinë dhe vërtetësinë e informatave të dhëna më sipër dhe marr përsipër që të njoftoj Bankën për çdo ndryshim të mëvonshëm të të dhënave të paraqitura.